



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “BE – IS SH.P.K” *shpk*

**Adresa:** Kukes, Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1.

**Procedura e prokurimit:** “Procedurë e Hapur”.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Ndërtimi terreneve sportive dhe muri rrethues për shkollat Mustafa Greblleshi dhe Sandër Prosi”

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-05423-05-20-2024

### Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

**Fondi limit:** 29,546,459.05 (njëzet e nente milion e pesëqind e dyzet e gjashte mijë e katerqind e pesëdhjetë e nente pike zero pese) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024 miratuar me VKB Nr. 125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 4 (katër) muaj kalendarike .

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit:** 05 / 06 /2024 Ora 10: 00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.27 datë 27.05.2024.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Operatori Ekonomik “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk**

**NIPT K82230002K**

Vlera e ofertës: 21,322,066.50 (njëzet e një milion e treqind e njëzet e dy mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori Ekonomik “BE - IS SH.P.K” shpk**

**NIPT K71412003A**

Vlera e ofertës: 23,182,000 (njëzet e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH.

**3. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “I 2 A SHPK & NDREGJONI SHPK” shpk**

**NIPT M11630006B NIPT K31329048I**

Vlera e ofertës: 25,130,527 (njëzet e pese milion e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë ) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “SENKA” shpk**

**NIPT J94808405Q**

Vlera e ofertës: 29,546,459.04 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e katëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë zero katër) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:*

1.Oferta e paraqitur nga *operatori ekonomik* “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk NIPT K82230002K

Operatori ekonomik “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk nuk ploteson DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3, pasi nuk ka paraqitur Deklaratë për Drejtusin teknik të punimeve.

Referuar Formularit të Vetdeklarimit, rezulton se shoqëria “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk nuk ka deklaruar punonjës Ekspert zjarrëfikës, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.

Referuar Formularit të Vetdeklarimit, rezulton se shoqëria “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk nuk ka deklaruar stafin teknik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.

Operatori ekonomik nuk plotëson dokumentat e tenderit, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 10, pasi nuk ka paraqitur Grafikon e punimeve të detajuar sipas afatit kohor të përcaktuar në DST.

Shoqëria “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk nuk ka deklaruar në Shtojcën 8, se disponon 1 (një) mjet Autobitumatriçe, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Deklaratë për verifikimin e mjeteve dhe të pajisjeve të deklaruara sipas Shtojcës 8, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.1.

Gjithashtu OE nuk ka paraqitur Deklaratë që mjetet/pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera si dhe nuk janë të deklaruara në procedurat e shpallura fitues nga AK, Bashkia Tiranë, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.2.

OE nuk plotëson Dokumentat e Tenderit, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 12.3, pasi nuk ka paraqitur Deklaratë për vendodhjen e mjeteve në pronësi/me qera me qëllim verifikimi nga AK.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “I 2 A” shpk & “NDREGJONI” shpk  
NIPT M11630006B NIPT K31329048I

- Shoqëria “I 2 A” shpk dhe shoqëria “NDREGJONI” shpk nuk kanë paraqitur Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (ISO 39001-2012), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 11, gërma “d”.
- Referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit, rezulton se shoqëria “I 2 A” shpk ka marrë përsipër të realizojë punimet elektrike sipas Preventivit të punimeve. Referuar Licenses profesionale, rezulton se kjo shoqëri nuk është e licensuar për kategorinë *NP-11A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BE – IS SH.P.K” shpk, Adresa: Kukes, Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1**, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera e ofertës = **23,182,000** (njëzet e tre milion e njëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *autoritetit kontraktor Bashkia e Tiranës me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Nd.2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax 00355422*

56799, **sigurimin e kontratës** siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_